



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
AUTORITETI I KONKURRENCËS

Njoftim Përqendrimi

Rasti: Përfitim Kontrolli: Telekom Slovenije d.d. / Jordan Podjetje Za Zaposlovanje In Usposabljanje Invalidov Krsko d.o.o

Autoriteti i Konkurrencës ka marrë njoftimin e transaksionit të realizuar me anë të “Marrëveshjes për shitjen dhe transferimin e aksioneve”, të nënshkruar me datë 20 shtator 2017 nëpërmjet të cilës synohet të realizohet transferimi dhe shitja e aksioneve të ndërmarrjes Jordan Podjetje Za Zaposlovanje In Usposabljanje Invalidov Krsko d.o.o (“Target”) tek ndërmarrja Telekom Slovenije d.d. (“Blerësi”).

Ky njoftim bëhet për shkak se Blerësi plotëson kriteret e xhirove në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar sipas parashikimeve të nenit 12 të Ligjit Nr. 9121, datë 28.07.2003 “Për Mbrojtjen e Konkurrencës” i ndryshuar (“Ligji”).

Veprimtaria e palëve pjesëmarrëse:

- Telekom Slovenija d.d., ndërmarrje sllovene, është ndërmarrja kontrolluese përfundimtare e Grupit Telekom Slovenija dhe është e angazhuar kryesisht në ofrimin e shërbimeve të lidhura me rrjetet (telekomunikacioni) në Slloveni dhe jashtë saj. Shërbimet e telekomunikacionit të ofruara nga Grupit Telekom Slovenija përfshijnë telefoninë zanore fikse dhe të lëvizshme, transmetim fiks dhe të lëvizshëm të dhënash, akses interneti me brez ët gjerë dhe akses në rrjete televizioni.
- Jordan Podjetje Za Zaposlovanje In Usposabljanje Invalidov Krsko d.o.o. ndërmarrje sllovene, një shoqëri e cila merret me trajnimin dhe punësimin e njerëzve me aftësi të kufizuara dhe është aktiv në prodhimin e artikujve prej letre dhe kartoni. Jordan nuk ka aktivitet në Shqipëri.

Nga shqyrtimi i dokumentacionit, rezulton se transaksioni i njoftuar është në përputhje me nenin 10, pika 1, shkronja b dhe c, dhe nenin 12, pika 1 dhe 2, të Ligjit, sipas të cilit duhet respektivisht të realizohet ndryshimi i qëndrueshëm i kontrollit si dhe të plotësohen kriteret e xhiros në tregun e brendshëm dhe atë ndërkombëtar.

Autoriteti fton palët e interesuara të shprehin opinionet e tyre për transaksionin e njoftuar. Opinionet duhet të paraqiten jo më vonë se 15 ditë nga publikimi i këtij njoftimi.

Opinionet mund të dërgohen pranë Autoritetit të Konkurrencës me fax (nr. 0355 4 2234 497), me postë në adresën: Autoriteti i Konkurrencës, Rr. “Sami Frashëri”, Nr 4, Kati IV Tiranë; apo me e-mail në adresën competition@caa.gov.al